



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më 11.12.2025		
Dostavljeno	Nr. Br.	Shtojkë - Prilog
02-06001-0079916/25		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Për: Kuvendit të Komunës së Podujevës

Përmes: Anëtarit më të moshuar të Kuvendit të Komunës z.Isak Ejupi

Çështja: Caktimi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës

Të nderuar/a,

Siç jeni dijeni, më datë 01.12.2025 është bërë inaugurimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës, si rezultat i certifikimit të zgjedhjeve lokale të 12 tetorit 2025, përkatësisht është bërë Betimi solemn i anëtarëve të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës.

Në kuadër të procesit të konstituimit, në këtë fazë që jemi parashihet zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa.

Në këtë kontekst, duke respektuar afatet ligjore përkatëse si dhe dispozitat tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, kërkohet thirrja e mbledhjes së Kuvendit të Komunës, dhe atë më **29.12.2025, nga ora 10:00**, me këtë rend të ditës:

- **Fillimisht, Dhënia e Betimit nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës,**
(zëvendësimi i ish anëtarëve të cilët janë emëruar në kuadër të Ekzekutivit të Komunës)
- **Procesverbali nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 01.12.2025**
- **Zgjedhja e Kryesuesit/ses të Kuvendit të Komunës së Podujevës**
 - Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit
 - Propozimi i kandidatëve
 - Procesi i votimit
 - Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit
- **Themelimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa**

Me respekt,

Podujevë,
12 dhjetor 2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 42.5 dhe të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, neni 4 paragrafi 6 dhe nenit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neneve 36 paragrafi 5 dhe 38 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, nenin 6 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010, në pajtim Shkresën / Opinionin e MAPL-së nr.020-992 të datës 29.12.2021, si dhe në kërkesë të Kryetarit të Komunës, nr.prot.02-060/01-0079916/25, të datës 12.12.2025.

THIRRET

Mbledhja e II-të (dytë - mandati VIII)-e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **29 dhjetor 2025, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës**, në orën **10:00**, dhe propozoj këtë;

Dhënia e Betimit nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës,
(zëvendësimi i ish anëtarëve të cilët janë emëruar në kuadër të Ekzekutivit të Komunës)

REND TË DITËS

1. Procesverbali nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 01.12.2025
2. Zgjedhja e Kryesuesit/ses të Kuvendit të Komunës së Podujevës
 - Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit
 - Propozimi i kandidatëve
 - Procesi i votimit
 - Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit
3. Themelimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa
 - (Propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa)

Podujevë,
12 dhjetor 2025

Anëtar i moshuar i Kuvendit
Isak Ejupi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 01 dhjetor 2025, në mbledhjen e I-rë (një) -mbledhje inauguruese, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VIII.

Mbledhja filloi në orën 10:45 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunës, në ndërtesën e re të Komunës së Podujevës.

Mbledhjen e kryesoi z.Isak Ejupi, anëtar më i moshuar i zgjedhur, certifikuar dhe emëruar nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve - KQZ.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e zgjedhur, certifikuar dhe emëruar këshilltarë/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës sipas Vendimit të KQZ-së nr.01/3376-2025 të datës 21.11.2025, si dhe Vendimeve të KQZ-së nr.01/3457-2025 dhe nr.01/3443-2025 të datës 27.11.2025, sipas të cilëve janë bërë 2 zëvendësime nga lista fillestare e certifikuar.

Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i zgjedhur i Komunës së Podujevës dhe i certifikuar nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, me Vendimin nr.01/3112-2025 të datës 03.11.2025.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Shoqatave të dala nga lufta Florim Statofci; përfaqësuesi i Stacionit të Policisë në Podujevë Kapiten Bashkim Bajrami; përfaqësuesi i Bashkësisë Islame në Podujevë Idiz Bilalli; anëtar i familjes (vëllai) i Heroit Kombëtar Afrim Zhitia; familjarë të Kryetarit të Zgjedhur të Komunës; përfaqësuesi i subjektit-Unioni i Blakçorve Samet Arifi; përfaqësuesit e KFOR; përfaqësuesi i OSBE; zyrtar/e të Institucioneve lokale të Komunës së Podujevës, media lokale “TV Llapi” si dhe një numër i zyrtarëve komunal dhe qytetarëve (rreth 20).

Linku i video incizimit të mbledhjes: <https://www.youtube.com/watch?v=wrZYvOvzrhk>

Intonimi i Himnit Kombëtar dhe Himnit të Republikës së Kosovës

1. Hapja dhe kryesimi i mbledhjes nga këshilltari më i moshuar i zgjedhur i Kuvendit

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, e hapi mbledhjen, theksoi, konstatoj se mund të fillohet me seancën, fillimisht më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, i nderuari Kryetar i Komunës së Podujevës zotëri Shpejtim Bulliqi, të nderuar anëtarë dhe anëtare të zgjedhur të Kuvendit të Komunës së Podujevës, të nderuar përfaqësues të institucioneve të sigurisë; Kapiten Bashkim Bajrami, përfaqësues të KFOR, përfaqësues i Bashkësisë Islami, përfaqësues të Mediave, Shoqërisë Civile, zonja dhe zotërinj, më lejoni që të fillojmë me punimet e kësaj seance solemne për konstituimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës të dalë pas zgjedhjeve lokale të mbajtura më 12 tetor 2025.

Fillimisht ju informoj se sipas të dhënave të cilat i posedon dhe ka përpunuar Zyra ligjore e Kuvendit Komunal në Podujevë, është konstatuar që unë Isak Ejupi i lindur më 06.11.1960, jam anëtari më i moshuar i kësaj përbërje të Kuvendit, mirëpo ju lus që ndoshta është ndokush tjetër më në moshë se unë të lajmërohet, nëse jo sigurisht që edhe tani, (meqë nuk po lajmërohet askush) konstatohet se unë jam anëtari më i moshuar i kësaj përbërje të Kuvendit të Komunës së Podujevës dhe mund të vazhdoj me kryesimin e punimeve të kësaj seance sipas rendit të ditës.

Para se të fillojmë me procesin sipas thirrjes së kësaj mbledhje, sipas njoftimit që kam nga Zyra për punë të Kuvendit, ftesa dhe materiali përkatës për këtë mbledhje është përcjellë përmes e-maileve personale të secilit prej anëtarëve të certifikuar dhe emëruar sipas rezultateve të shpallura nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve për Kuvendin e Komunës së Podujevës.

Zotëri Kryetar i zgjedhur i Komunës së Podujevës, anëtarë/e të zgjedhur të Kuvendit të Komunës, mysafirë të nderuar, zonja dhe zotërinj, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (nenit 42.5), në Udhëzimin Administrativ nr.02/2015 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës (nenit 4.6), Statutin e Komunës së Podujevës (neni 36.5) dhe në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e hapi këtë mbledhje inauguruese të Kuvendit të Komunës së Podujevës, sipas ftesës dhe rendit përkatës të ditës të cilin veç se e keni marrë të gjithë.

Para se të vazhdojmë me punë, ju informoj se në bazë të listës së nënshkruar, të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë të zgjedhurit anëtarë/e të Kuvendit të Komunës nga ky proces zgjedhor, do të thotë të gjithë të certifikuarit nga KQZ në bazë të Vendimit nr.01/3376-2025 të datës 21 nëntor 2025, si dhe Vendimet përcjellëse nr.01/3457-2025 dhe nr.01/3443-2025 të datës 27.11.2025, sipas të cilave janë bërë 2 zëvendësime nga lista fillestare e certifikuar për çka sigurisht se në vazhdim do të bëhet verifikimi nga Komisioni verifikues.

Pra konstatoj se kuorum ekziston për punë dhe mund të vazhdohet tutje me mbledhjen, dhe kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Ngritja e Komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, sa i përket kësaj çështje, me legjislacionin në fuqi parashihet ngritja e një Komisioni për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Duke marrë për bazë nga praktika në të kaluarën, Komisioni në fjalë është ngritë në përbërje prej 3 anëtarëve nga subjektet politike me numrin më të madh të anëtarëve që përfaqësohen në Kuvend, mirëpo nëse ndokush ka kërkesë shtesë nga subjektet tjera mund të propozoj, edhe pse unë po vlerësoj se në këto rrethana që aktualisht jemi, mjaftueshëm janë 3 anëtarë por si do qoftë nëse ndokush ka kërkesë shtesë, ju lus të propozoni, pra urdhëroni nëse ka kërkesë që përbërja e këtij komisioni të jetë me numër më të madh dhe me përfshirje më të gjerë, nëse jo, atëherë konstatoj se Komisioni verifikues do të përbëhet prej tri subjekteve me numrin më të madh të anëtarëve që përfaqësohen në këtë Kuvend.

Konstatohet që unanimisht mbështetet propozimi që Komisioni për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të përbëhet prej 3 anëtarëve dhe atë nga tri subjektet me numrin më të madh të anëtarëve në këtë përbërje të Kuvendit të Komunës (LVV, LDK, PDK)

Kryesues i mbledhjes, vazhdoi, tani mund të fillojmë me propozimet sipas radhës ku ftoj përfaqësuesit e tri subjekteve përkatëse politike, fillimisht Lëvizja Vetëvendosje, pastaj Lidhja Demokratike e Kosovës, dhe mandej Partia Demokratike e Kosovës:

z.Avni Fetahu, theksoi, si Lëvizje Vetëvendosje, propozojmë Artrit Mulliqin.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne si Grup i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e propozojmë profesor Besim Latifin.

z.Isak Shabani, theksoi, fillimisht shfrytëzoj rastin t'i uroj të gjithë të zgjedhurit këtu anëtarë/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës, gjithashtu edhe Kryetarin e Komunës.

Në emër të Grupit të këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës, e propozoj Lulzim Pollomin.

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, kemi një kërkesë nga administrata që në këtë rast të paktën njëri prej anëtarëve të Komisionit në fjalë të jetë femër për shkak të kuotës gjinore, andaj nëse mund ta ndryshoni propozimin i nderuari zotëri Shabani.

z.Isak Shabani, theksoi, atëherë meqë po kërkohet nga ne, e tërheqim propozimin paraprak, dhe e propozoj Rinesa Goxhufin.

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, faleminderit zotëri Shabani që e ndihmuat procesin në këtë rast, dhe tani me ngritje të dorës mund të votohet për përbërjen e këtij Komisioni sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se njëzëri me 35 vota Për, përkrahet propozimi që Komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit të ngritët në përbërje prej 3 anëtarëve, në këtë përbërje:

- 1. z.Artit Mulliqi,*
- 2. z.Besim Latifi,*
- 3. znj.Rinesa Goxhufi*

Kryesuesi i mbledhjes, vazhdoi, tani lus Komisionin në fjalë të filloj me punë sa i përket verifikimit të mandateve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Komisioni për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit, në asistencë të zyrtarit për punë të Kuvendit kryesisht për ofrimin e dokumentacionit të nevojshëm të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve, bënë verifikimin e mandatit të anëtarëve sipas listës së certifikuar nga KQZ dhe dokumentacionit përkatës që ndërlidhet me zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025, për Komunën e Podujevës, duke përfshirë edhe Vendimet përcjellëse të KQZ-së sipas të cilave para kësaj seance janë bërë edhe dy zëvendësime nga lista fillestare e certifikuar, dhe unanimisht pajtohen që çdo gjë është në rregull dhe që mund të vazhdohet tutje me punime, si dhe që në emër të Komisionit z.Artrit Mulliqi të paraqet raportin nga ky verifikim.

➤ **Raporti i Komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit**

z.Artrit Mulliqi, në emër të komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit, theksoi, i nderuari Kryetar i Komunës së Podujevës z.Shpejtim Bulliqi, të nderuar anëtarët më të rinj të Kuvendit të Komunës së Podujevës, në emër të komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit, e paraqes këtë raport.

Në bazë të verifikimit të mandateve të anëtarëve të certifikuar sipas dokumentacionit përkatës të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve dhe listës së nënshkrimeve të pjesëmarrjes në këtë mbledhje inauguruese, në emër të komisionit konstatojmë se prezent janë të gjithë, pra 35 anëtarë/e të certifikuar dhe emëruar të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

35 anëtarët/et e certifikuar në emër të Kuvendit të Komunës së Podujevës, në vazhdim duke u mbështetur në këtë dokumentacion përkatës të KQZ-së që posedon zyra për punë të Kuvendit që u ceken pak më parë edhe nga Kryesuesi i mbledhjes, sipas radhës do i thërras me emër e mbiemër si dhe njëkohësisht duke konstatuar prezencën dhe jo prezencën e anëtarëve/ve të Kuvendit të Komunës së Podujevës të cilët kanë marrë numrin e mjaftueshëm dhe të cilët figurojnë në dokumentacionin e Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve.

Pra në vazhdim po i lexoj me emër e mbiemër:

I'u lexohen emrat dhe mbiemrat si dhe duke konstatuar prezencën e anëtarëve/ve të Kuvendit të Komunës së Podujevës të cilët kanë marrë numrin e mjaftueshëm për anëtar/e të Kuvendit dhe të cilët janë në listën e certifikuar dhe nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, përfshirë edhe anëtarët e zëvendësuar / emëruar pas certifikimit të rezultateve përfundimtare, dhe atë;

(Avni Fetahu, Adelina Stublla, Bahri Selimi, Lirie Hoti-Rama, Artrit Mulliqi, Fatri Zhitija, Kasib Bashota, Florent Hasani, Valdet Kamerolli, Vigan Salihu, Arbrim Konushefci, Flandra Kadriu, Luljeta Muçolli-Azemi, Vlora Jashanica, Haki Rudari, Enis Shabani, Alisa Jetullahu, Enis Dervisholli, Besim Latifi, Valdet Restelica, Blerta Azemi-Berisha, Valon Demolli, Ekrem Rrahmani, Ermal Osmani, Gresa Qosa-Maqastena, Arben Xhemajli, Arnisa Sylejmani, Isak Ejupi, Isak Shabani, Lulzim Pollomi, Mimoza Abdullahu, Rinesa Goxhufi, Demokrat Hodolli, Gentrit Arifi, Baki Feta)

z.Artrit Mulliqi, vazhdoi, me këtë rast, në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve, konstatojmë se me këtë përmbillet procesi i verifikimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës nga rezultatet e dala në zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025. Urime të gjithëve.

Kryesues i mbledhjes, falënderoj Komisionin dhe njëkohësisht shfrytëzoj rastin që tani t'ju kërkoj falje që këtë material e kam marrë para pak minutave se të filloj kjo seancë dhe sigurisht që nuk e kam shqyrtuar më parë. Unë zakonisht nuk foli me tekste të shkruara përveç kur përdori statistika, kështu që edhe të lexoj edhe ta them atë çka unë e di, do të thotë nuk është e njëjtë, por si do qoftë kërkoj ndjesë nëse më kalon ndonjë gabim eventual.

Do të thotë, dëgjuam Raportin e Komisionit për verifikimin e mandateve dhe besoj çdo gjë është e qartë tani, dhe mund të kalojmë në pikën e radhës.

3. Dhënia e Betimit nga anëtarët dhe anëtarët e Kuvendit

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, unë do ta lexoj tekstin e betimit, kurse Ju kolegë të nderuar në pëshpëritje e përsëritni të njëjtin, përveç kur unë e them emrin dhe mbiemrin tim, ju e potenconi tuajin, dhe pastaj konsiderojmë se dhënia e betimit solemn është proces i përfunduar, tani ju ftoj të ngritemi në këmbë të gjithë dhe fillojmë me këtë proces të dhënies së betimit. Pra fillojmë...

Me tekstin si në vijim:

“Unë, (duke e cekur e lexuar secili emrin dhe mbiemrin e tij) betohem se do t’i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”

Konstatohet që solemnisht jepet Betimi dhe nënshkruhen Deklaratat përkatëse, nga anëtarët/et e zgjedhur të Kuvendit të Komunës së Podujevës nga zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025, si vijon:

Avni Fetahu.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Adelina Stublla.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Bahri Selimi.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Lirie Hoti - Rama.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Artrit Mulliqi.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Fatri Zhitija.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Kasib Bashota.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Florent Hasani.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Valdet Kamerolli.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Vigan Salihu.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Arbrim Konushefci.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Flandra Kadriu.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Luljeta Muçolli-Azemi.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Vlora Jashanica.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Haki Rudari.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LVV
Enis Shabani.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Alisa Jetullahu.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Enis Dervisholli.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Besim Latifi.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Valdet Restelica.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Blerta Azemi-Berisha.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Valon Demolli.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Ekrem Rrahmani.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Ermal Osmani.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Gresa Qosa-Maqastena.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Arben Xhemajli.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Arnisa Sylejmani.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Isak Ejupi.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK
Isak Shabani.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik PDK
Lulzim Pollomi.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik PDK
Mimoza Abdullahu.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik PDK
Rinesa Goxhufi.....anëtare e Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik PDK
Demokrat Hodolli.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik Guvo
Gentrit Arifi.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit Unioni i Blakçorve UB
Baki Feta.....anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik AAK

Kryesuesi i zgjedhjes, theksoi, tani luteni që pasi t’i nënshkruani Deklaratat e betimit, të cilat pasi që zyrtarët e administratës t’i vulosin do t’ju kthehet nga një që t’i keni si dokumente personale, pastaj kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës. Pra nga ky moment edhe zyrtarisht jemi anëtarë/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës, urime suksese dhe punë të mbarë gjithsecilit.

4. Dhënia e Betimit nga Kryetari i zgjedhur i Komunës

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, tani në radhë kemi pikën e rendit të ditës që është dhënia e betimit nga Kryetari i Komunës së Podujevës i zgjedhur në zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025 z.Shpejtim Bulliqi. Urdhëroni zotëri Kryetar.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i zgjedhur i Komunës së Podujevës, duke filluar me leximin e Deklaratës së betimit, me theks bazën ligjore; *Mbështetur në nenin 57.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në pajtim me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenin 60 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-50862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe Vendimin e Komisionit Qendrorë Zgjedhor nr.01/3112-2025 të datës 03 nëntor 2025 për Certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale 2025 për Kryetar Komune në Podujevë.*

Me tekstin si vijim,

“Unë, SHPEJTIM BULLIQI, betohem që do t’i kryejë detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Podujevës, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushtet për jetë të qetë për të gjithë”

Podujevë, 01 dhjetor 2025

u konstatua që jep Betimin solemn dhe nënshkruan Deklaratën e Betimit z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i zgjedhur i Komunës së Podujevës nga zgjedhjet lokale të mbajtura 12 tetor 2025

Kryesues i mbledhjes, theksoi, urime zotëri Kryetar, ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese. Kalojmë në pikën e radhës sipas rendit të ditës që është fjalë rasti e Kryetarit të Komunës të cilin tani e ftoj të paraqet një fjalë rasti.

5. Fjala e rastit e z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i respektuari Kryesues i mbledhjes së Kuvendit, të nderuar anëtarë/e të Kuvendit Komunal, të respektuar mysafirë të pranishëm, Komandant i Stacionit Policor në Podujevë, i respektuari Imam Idriz Bilalli, të nderuara familje të Dëshmorëve, Invalidë dhe Veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar përfaqësues të Institucioneve, të respektuara media dhe anëtarë të Shoqërisë Civile, të dashur qytetarë të Komunës së Podujevës, të respektuar miq dhe familjarë, përfaqësues të KFOR.

Fjalimin tim në këtë seancë solemne dua ta filloj së pari duke ju uruar mandatin si këshilltarë komunal të gjithë juve të nderuar asamblistë që keni fituar besimin e qytetarëve për t’i përfaqësuar ata në Kuvendin Komunal.

Besimi me votë që kemi marrë nga ana e qytetarëve është nder, privilegj dhe përgjegjësi e madhe, që unë besoj se ju si përfaqësues të qytetarëve do t’i mbronit interesat e tyre dhe interesat e Komunës me përgjegjësi e përkushtim maksimal.

Nga kjo foltore dua t’i falënderoj asamblistët e mandatit të kaluar për bashkëpunimin e mirë që kemi pasur në shtyrjen përpara të projekteve dhe punëve të mira në interes të qytetarëve dhe në interes të Komunës.

Si Kryetar i Komunës, unë ua shtrij dorën e bashkëpunimit të gjithë juve të nderuar kuvendarë, pa dallim partie, që të punojmë bashkërisht e të shtyjmë përpara projektet që zhvillojnë Komunën tonë dhe mbrojnë interesin e përgjithshëm.

Të nderuar të pranishëm, kam nderin e veçantë t'ju drejtohem nga kjo foltore përsëri si Kryetar i Komunës, i zgjedhur nga qytetarët nga një proces shumë demokratik e fer nga zgjedhjet që lamë pas, ku qytetarët vlerësuan punën tonë të mirë dhe na besuan për të vazhduar qeverisjen e mirë e transformuese në Komunën e Podujevës.

Jam jashtëzakonisht i nderuar dhe po aq përgjegjës që me bindjen e lirë e me vullnet të qartë qytetarët e Podujevës ma kanë deleguar detyrën e drejtimit të Ekzekutivit të Komunës tonë edhe për një mandat të ri. Pra më është besuar detyra që të udhëheq një Komunë që ashtu siç e ka dashur puna dhe detyra e atdheut tonë, gjithmonë i është përgjigjur siç është më së miri. Pra një Komunë me traditë e identitet të fuqishëm Kombëtar e kolektiv të dëshmuar në çdo rrethanë.

E kam thënë edhe në ditën e parë kur e kam pranuar mandatin e Kryetarit më 7 dhjetor të vitit 2020, e do ta them çdo herë në çfarëdo cilësie se, kur e ka dashur puna e sakrifica për lirinë, të drejtat dhe mëvetësinë e tij, Llapi i ka dhënë Kosovës emra si Adem Demaçi e Shaban Shala. Kur e ka dashur puna që aspiratat tona Kombëtare të merrnin formën e pa kompromis të rezistencës ndaj pushtimit, Llapi po ashtu i ka dhënë Kosovës emra si Zahir Pajaziti, Afrim Zhitia, Ali Ajeti e Ilir Konusheci.

Kur e kërkon puna që aspiratat tona Kombëtare dhe artikulimi i projektit politik për liri, pavarësi dhe vetëvendosje të pikëtakoheshin me parimet universale politike, filozofike e morale të botës së qytetëruar, Llapi i jep prap Kosovës emra si Enver Maloku dhe Xhemajl Mustafa. Kur më së shumti kishte nevojë që Kosova të dëshmonte vitalitetin, energjinë dhe përkushtimin kolektiv për vlera kulturore e artistike, Llapi i jep Kosovës prap emra si Avdush Hasani, Ismet Bogujevci dhe artistë të tjerë të mëdhenj. Kur e njëjta ndihej në sportet kolektive ne i kemi dhënë vendit sportistë legjenda si Fadil Vokrri e Favzi Rama.

Në këtë ditë solemne, kur marrim përgjegjësi të reja për të ardhmen kujtojmë me respekt e mirënjohje të thellë gjithë përpjekjet historike drejt lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, duke filluar nga Familja Jashari, komandantin legjendar Adem Jashari, që me sakrificën e tij e vulosi rrugën tonë drejt lirisë. Gjithashtu kujtojmë e nderojmë Presidentin Historik, Doktor Ibrahim Rugova, i cili me vizionin e tij ndërtoi ura bashkëpunimi të Kosovës me botën e civilizuar dhe trasoi rrugën drejt lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj, i përmenda të gjitha epokat dhe personalitetet tona historike për të argumentuar bindjen time se sa herë marrim përgjegjësi para qytetarëve, na takon të kemi parasysh sfidën dhe dedikimin për të përmbushur atë për të cilën na kanë besuar qytetarët.

Unë zotohem para Llapjanëve që Zyra e Kryetarit të Komunës do të udhëhiqet nga parimi i gjithëpërfshirjes dhe trajtimit të barabartë sipas ligjit. Shërbimi për qytetarët dhe ndaj qytetarëve do të jetë detyrë e jona e përditshme.

Ju bëj thirrje qytetarëve, të rinjve dhe kuadrove të shumta që ka Llapi, të cilët kanë vullnetin, gatishmërinë dhe idealin për të kontribuar me ide apo çfarëdo lloj ndihme për Komunën e tyre, të na drejtohen, të na bashkohen dhe të na ndihmojnë.

Dua t'i falënderoj të gjithë qytetarët, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, por edhe bashkëpunëtorët dhe kolegët që punuan shumë për realizimin e fitores sonë dhe vazhdimin e ndryshimit progresiv në Komunën e Podujevës.

Dua t'i falënderoj edhe ata qytetarë që nuk më votuan mua, por besuan më shumë tek alternativat e tjera, për sjellje korrekte, dinjitoze dhe të qytetëruar. Komuna e Podujevës do t'i mirëpres, dëgjojë e sigurojë bashkëpunim e bashkëveprim korrekt me të gjithë, pa asnjë dallim a diskriminim.

Edhe gjatë mandatit të kaluar kemi dëshmuar se mund të bëjmë punë të mëdha për Komunën tonë si në zhvillimin ekonomik lokal, infrastrukturë, arsim, shëndetësi e të tjera, prandaj në këtë frymë do të vazhdojmë edhe në mandatin e ri për transformimin e plotë të Komunës tonë. Na priftë e mbara.

Ju faleminderit.

z.Isak Ejupi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, të nderuar anëtar dhe anëtare të Kuvendit të Komunës së Podujevës, ju njoftoj se në afatin sa më të shkurtër të mundshëm duhet t'i depononi kopjet e letërnjoftimit dhe konfirmimi i llogarisë bankare tuaj, do të thotë dokumentet e cekura të dorëzohen në Zyrën ligjore, zyra nr.52.

Po ashtu ju njoftoj se tani pas kësaj mbledhje do të organizohen homazhe pranë monumenteve të Heronjve tanë, kështu që ju ftoj të gjithëve të bashkëngjiteni në këtë ceremoni.

Ju faleminderit shumë dhe me kaq e konstatoj se mbledhja inauguruese ose konstituive e Kuvendit të Komunës së Podujevës përfundon punimet.

Mbledhja përfundoi në ora 11:25

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0077581/25
Podujevë,
01 dhjetor 2025**

Kryesuesi i mbledhjes
anëtar i më i moshuar në moshë

Isak Ejupi _____



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 51.1 dhe 52.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, si dhe neneve 14, 47 paragrafi 1 dhe 48 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i **Propozohet**

V E N D I M **PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E** **KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Neni 1

Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa-KPF i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- | | | |
|----|-------|--------------------------------------|
| 1- | _____ | Kryesuesi i Kuvendit (sipas pozitës) |
| 2- | _____ | nga subjekti politik _____ |
| 3- | _____ | nga subjekti politik _____ |
| 4- | _____ | nga subjekti politik _____ |
| 5- | _____ | nga subjekti politik _____ |
| 6- | _____ | nga subjekti politik _____ |
| 7- | _____ | nga subjekti politik _____ |
| 8- | _____ | nga subjekti politik _____ |
| 9- | _____ | nga subjekti politik _____ |

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komitetit për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, dhe dispozitat tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Podujevë, 12 dhjetor 2025